

Kur t'komenton se çka ki veshë, qysh po dokesh, qysh po ecë ose edhe qysh po keshë...

Kur t'folë e nihesh n'siklet!

Kur t'folë, t'ndjekë ose t'prekë

Kur 'detyrohesh' me heshtë veç pse dikush ka një 'pozitiv'

Kur ndihesh në faj pa bo kur gjë



...ky është **Ngacmim Seksual**

Ngacmimi Seksual dënohet me ligj.

Ngacmimi Seksual në Kosovë

Kjo broshurë është krijuar nga Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis

Mbështetur nga Swedish International Development Cooperation Agency – Sida / Community Development Fund – CDF dhe CFD – The Feminist Peace Organization – Zvicër.

Përgatitur nga **Diellza Bezera** me kontribut të **Arta Tërstena**

Redaktuar nga **Vjollca Krasniqi**

Përthyer në gjuhën angleze nga **Zana Kurteshi**

Përkthyer në gjuhën serbe nga **Stefana Živković**

Prishtinë

Prill, 2020



Definicioni sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Ngacmimi seksual nënkupton cilëndo formë të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues.

Format e Ngacmimit Seksual

Ngacmim gjinor (më i zakonshmi)

Deklarata seksuale të përgjithësuara dhe sjellje që përcjellin qëndrime fyese ose poshtëruese për gratë ose burrat. Shembuj: vërejtje fyese, shaka të turpshme ose humor rreth seksit, etj.

Sjellje joshëse

Sjellje seksuale të padëshiruara, të papërshtatshme dhe fyese. Shembuj përfshijnë ftesën seksuale të përsëritur dhe të padëshiruar; kërkesa këmbëngulëse për takime / darkë / pije; letra të vazhdueshme, thirrje telefonike, etj.

Kërkesë seksuale

Kërkimi i aktivitetit seksual ose sjelljeve të tjera të lidhura me seksin duke premtuar shpërblim; propozimi mund të jetë ose i drejt për drejt ose i imponuar.

Kërcënim seksual

Shtrengim i aktivitetit seksual ose sjellje tjetër e lidhur me seksin me anë të kërcënimit të dënimit; shembujt përfshijnë vlerësime negative të performancës, pengimin në dhënien e promovimit, kërcënimin për mos përfshirje në provim.

Imponim seksual

Detyrim seksual (siç është prekja me forcë, ndjenja, kapja) ose sulmi seksual. (Burimi: Shoqata Psikologjike Amerikane)

Sjelljet të cilat konsiderohen ngacmim seksual mund të jenë të natyrës

(por nuk kufizohen vetëm me)



Verbale



Joverbale



Fizike



Vizuele

Sjelljet të padëshiruara
verbale



- Komentimi me përmbajtje seksuale ndaj trupit, apo dukjes fizike të personit
- Thirrja në emra ledhatues
- Tregimi i barcoletave me përmbajtje seksuale
- Kthimi i temës së punës në tema me natyrë seksuale
- Parashtrimi i pyetjeve për jetën personale, për lidhjet dhe jetën intime
- Përhapja e thashethemeve për jetën seksuale të personit
- Kërkimi për takime jashtë vendit të punës

Sjelljet të padëshiruara
jo verbale



- Shiqimi i personit nga lart poshtë
- Shiqimi ngultas në sy apo shkelja e syrit
- Pengimi i rrugës së personit
- Ndjekja pas/përcjellja
- Ofrimi i dhuratave personale
- Gjeste me karakter seksual, mimikë, duar apo lëvizje trupore
- Fishkëllima

Sjelljet të padëshiruara
fizike



- Prekja rreth qafës dhe krahëve
- Prekja e rrobave, flokëve apo trupit
- Përqafimi, shtrëngimi i duarve pa dëshirë,
- Prekja, pickimi apo fërkimi me trup
- Qëndrimi afër apo largimi i gjërave nga trupi

Sjelljet të padëshiruara
vizuele



- Dërgimi i fotove dhe videove me përmbajtje seksuale
- Dërgimi i porosive (sms, e-mail, letra, komente etj.) me përmbajtje seksuale
- Prezantimi materialeve me përmbajtje seksuale

Çka na thotë ligji!?

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (amandamentuar prill 2019):

Neni 113, pika 37. 39.

Viktimë e ndjeshme - është viktima e veprës penale e cila është fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë, i/e moshuar ose person marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryesit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur.

Neni 183 - Ngacmimi Seksual

1. Kushdo që ngacmon seksualisht personin tjetër, në veçanti personin i cili është i ndjeshëm për shkak të moshës, sëmundjes, paaftësisë, varësisë, shtatzënisë, paaftësisë së rëndë fizike apo mendore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.

Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryesi i cili është mësues, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja ose kujdesi i personit të tillë

apo në ndonjë mënyrë tjetër ka pozitë të autoritetit mbi atë person, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet

Kur vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose ndonjë sendi tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit mendor apo fizik, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 182

Kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë... ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit...dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Çka na thotë ligji!?

Neni 229-Sulmi seksual

1. Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.

Pika 4. Vëmendja apo komunikimi nga paragrafi 1. i këtij neni mund të përfshijë përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme të shtëpia, shkolla, puna apo qendra rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porosive; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.

Neni 22 Mbrojtja Juridike

1. Personat të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, mund të iniciojnë procedura dhe paraqesin prova para organit administrativ apo Gjykatës kompetente në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.

2. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, në rastet kur përbëjnë vepër penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dispozita kundërvajtëse: Gjobë në shumë prej pesëqind (500) deri në shtatëqind (700) euro do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës ose personit juridik, organit me autorizime publike ose individit i cili në formë të profesionit të regjistruar kryen veprimtari të caktuar, i cili në bazë gjinore do ta shkelë dinjitetin e personit të caktuar ose krijon mjedise, qasje ose praktikë kërcënuese, armiqësore, ofenduese ose shqetësuese (neni 3 nënparagrafi 1.1, 1.11, 1.12 të këtij ligji).

Cilat janë dëmet psikologjike të ngacmimeve seksuale!?

Ngacmimi seksual mundet thellësisht të prekë mirëqenien fizike, mentale dhe sociale të viktimave. Ngacmimi seksual ka pasoja të natyrës psikike, emocionale dhe fizike. Gjë e cila ndikon në integrimin mirëfilltë të gruas në shoqëri, pozitën e saj dhe avancimin e saj në çdo sferë tjetër.

Depresion, ankth, tronditje, mohim, konfuzion, ndjenja të qenit e/i pafuqishme/ëm, zemërim, frikë, zhgënjim, nervozizëm, turp, vetëdije, vetëbesim i ulët, pasiguri, siklet, ndjenja tradhtie, faj, vetë-faj , izolim janë disa prej gjendjeve psikologjike që shkaktohen nga ngacmimet seksuale te përjetuara.



Shtrirja e ngacmimit seksual në Kosovë

Në përgjithësi, rastet e ngacmimit seksual raportohen minimalisht në Kosovë, edhe pse prevalanca e personave që i janë nënshtruar ngacmimit seksual nuk është e ulët. Në raportin e publikuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës për rastet e ngacmimit seksual në Kosovë, vlerësohet se 48.5% e kosovarëve kanë përjetuar një formë të ngacmimit seksual. Në vitin 2014 45.2% e respondentëve kanë pretenduar se gjatë atij viti, ata kanë qenë të ekspozuar apo kanë përjetuar një formë të ngacmimit seksual. Nga ky numër 64.1% e rasteve kanë qenë gra që kanë raportuar një formë të ngacmimit seksual përkundër 32.5% të rasteve të burrave të raportuara.

në vitin

2014

45.2%

e respondentëve kanë përjetuar një formë të ngacmimit seksual

64.1%

e rasteve kanë qenë gra

32.5%

e rasteve kanë qenë burra

Personat e rinj kanë raportuar se kanë përjetuar ngacmim seksual më shumë se sa të moshuarat/it.

Në njohjen e asaj që çfarë konsiston ngacmimi seksual 69.3% e të intervistuarve identifikojnë veprat penale të dhunshme si forma të rasteve të ngacmimit seksual me dhunim ose tentativë përdhunimi që shihen si forma më karakteristike të ngacmimit seksual.

Më pak se gjysma e të anketuarve (49%) mendojnë se presioni për favore seksuale, prekja, pickimi, ose shtyrja dhe fishkëllima e dikujt në rrugë (43.8%), mund të përkufizohen si forma të ngacmimit seksual.



4.1% të të gjithë të anketuarat/it kanë raportuar ndonjëherë raste tek autoritetet ose kishin dijeni për dikë që ka raportuar rastin.

Më shumë se 74% e të anketuarve deklaruan se viktimat duhet të fajësohen kur ndodh ngacmimi seksual në qoftë se gruaja është e veshur ose sillet në mënyrë provokuese. Pak më shumë gra ishin të prirura që të pajtohen me këtë deklaratë se sa meshkujt me pothuajse një të tretën e kosovarëve që besojnë se njerëzit natyrisht ngacmojnë të tjerët, kur ata janë tërheqës për ta, më shumë meshkuj (35.4%) se femra (26.9%) pajtohen se sjellja është e pranueshme, me pothuajse 40% që pretendojnë se grave iu pëlqen të "ngacmohen."

Sipas disa hulumtimeve, nga ky fenomen më së shumti preken gratë dhe vajzat e reja. Gjatë vitit 2014, rreth 45% kanë përjetuar këtë lloj ngacmimi, ndërsa rreth 48% kanë përjetuar ndonjë formë të ngacimit seksual gjatë jetës së tyre. Grup moshat e reja janë ato që preken më së shumti nga këto ngacime.

Kultura e "fajësimit të viktimës", në rastet kur ka ngacmim seksual, është e përhapur gjerësisht, ku 74% e kosovarëve besojnë se "gratë u shkaktojnë vetë probleme vetes, duke u veshur dhe sjellë në mënyrë provokative." Një numër pak më i lartë i grave sesa ai i burrave bien dakord me këtë pohim.

Referencat

Kodi Penal i Republikës së Kosovës: <https://bit.ly/3cxyqUz>

Raporti 'Trajtimi i Ngacimit Seksual në Universitetet Publike në Kosovë' - Artpolis:
<https://bit.ly/2XTkA17>

Raporti 'Ngacimi Seksual në Kosovë' - Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës: <https://bit.ly/2RUfvvi>

Universiteti i Floridës së Jugut - Qendra për mbrojtjen e viktimave: <https://bit.ly/2VOTLSH>

Punimi "Ngacimet Seksuale në Kosovë - Emirëjeta Kumnova/Psikologe

Ky aktivitet është pjesë e Projektit 'HumanRightivism' implementuar nga Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF) dhe mbështetur nga Sida.

Implementuar nga:



Financuar nga:

